



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Plana / Porreze / Prenhena / Prilato Received / Delivery	10-02-2022	2	viti god year
Organ / Shista Organ / Jedinstvo Org / Unit	SKPM/SHIK	672/2022	1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1227/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca -anëtar dhe Avdyl Bektashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1227/2021 të datës 29.12.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë kundër Përgjigjes së datës 30.11.2021 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 10.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.1227/2021 të datës 29.12.2021 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 03.09.2012 në pozitën "Udhëheqës i Njesisë Ekonomike" në Shërbimin Korrektues të Kosovës, në bazë të Vendimit me Nr. 4391 të datës 24.12.2019 është transferuar në pozitën Udhëheqës i Njesisë për Punë Juridike dhe të Përgjithshme në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë.

Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues i Kosovës më datë 20.09.2021 ka nxjerr Vendim me Nr. 01062 me të cilin ka aprovuar kërkesën e ankuesit duke e shfuqizuar Vendimin me Nr. 431 të datës 24.12.2019 për transferimin e ankuesit.

Ankuesi më datë 29.10.2021 përmes shkresës me nr.1217 i është drejtuar Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, me kërkesë për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit. Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të



Kosovës më datë 30.11.2021 përmes shkresës me nr.1314 i është përgjigjur ankuesit në kërkesën e tij duke e njoftuar që në këtë fazë kërkesa refuzohet sepse një kërkesë e ngjashme është duke u trajtuar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Ankuesi, kundër përgjigjes së datës 30.11.2021, fizikisht më datë 29.12.2021 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot:6376/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 31.12.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Shërbimin Korrektues të Kosovës. Më datë 14.01.2022 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Shërbimi Korrektues të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesa e datës 29.12.2020 me Nr. Prot:6376/2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen e datës 30.11.2021 të Zv. Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së; Akt Emërimit e datës 03.09.2012 në emër të ankuesit; Emailin e datës 19.12.2019; Vendimin me Nr. 4391 të datës 24.12.2019 për transferimin e ankuesit; Vendimin me Nr.01062 i datës 20.09.2021 i Zv. Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së; Kupon Fiskal; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 31.12.2021; Përgjigjen në ankesë e datës 14.01.2022; Kërkesën për rishqyrtim të përgjigjes së datës 06.07.2021 e datës 20.09.2021; Përgjigje në kërkesë e datës 06.07.2021; Kërkesën për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit e datës 29.10.2021 nga ankuesi; Përshkrimi i detyrave të punës për Udhëheqës të Njësisë Ekonomike-SHKK.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e **pa bazuar, sepse:**

Fillimisht Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin A.nr.899/2021 të datës 17.12.2021 ka refuzuar ankesën për disa nëpunës të Shërbimit Korrektues të Kosovës në mesin e tyre edhe të ankuesit për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit me rastin e transferimit nga data 08.10.2018-07.06.2021, mirëpo në dosje të lëndës nuk ka pasur vendime për transferim të ankuesve, mirëpo në këtë ankesë të parashtruar më datë 29.12.2021 konstatohet se ankuesi posedon edhe vendimin për transferim dhe meqë ka prova të reja kolegji ka shqyrtuar themelsinë e ankesës dhe është vendos meritorisht për këtë çështje juridike.


Ankuesi në ankesën e datës 29.12.2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që transferimi më datë 24.12.2019 është bërë me presion dhe ka qenë i qëllimshëm për të më dëmtuar; po ashtu pretendon që t'i bëhet kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit për vajtje-ardhje në vlerën 1 Euro sipas nenit 5 të Rregullores Nr.06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civil.

Bazuar në shkresat e lëndës, para se të nxirret Vendimin me Nr. 4391 i datës 24.12.2019 për transferimin e ankuesit nga pozita Udhëheqës i Njesisë Ekonomike në Drejtorinë Qendrore të Shërbimit Korrektues të Kosovës në pozitën Udhëheqës i Njesisë për Punë Juridike dhe të Përgjithshme në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, ankuesi përmes emailit të datës 19.12.2019 të dërguar R.S, ka theksuar se: *"Pajtohem që të emërohem në pozitë të re udhëheqëse e cila është e brasvlershme-ekuivalente me pozitën time me Aktemërimin e datës 03.09.2012"* mirëpo në pikën 3 të këtij emaili thekson: *"vendi i punës të jetë në Drejtorinë Qendrore të SHKK-së"*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në shkresat e lëndës, konstaton se ankuesi para transferimit ka dhënë pëlqimin e tij lidhur me transferimin por që ka kërkuar të transferohet në Drejtorinë Qendrore, mirëpo me Vendimin me Nr. 4391 i datës 24.12.2019, është transferuar në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, kështu që edhe pse ankuesi pretendon që nuk është respektuar emaili respektivisht pëlqimi i tij, i njëjti lidhur me Vendimin me Nr. 4391 të datës 24.12.2019 nuk ka asnjë dëshmi që të ketë parashtruar ankesë brenda afateve ligjore të përcaktuara me nenin 127 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacion, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike administrative (këshillën juridike), afati i parashikuar nga paragrafi 1 i këtij neni, është tre (3) muaj"*, bazuar në këtë edhe kontestimi i këtij vendimi lidhur me atë që nuk është respektuar emaili i tij, është pretendim i pabazuar.

Neni 16 paragrafi 1 i Ligjit Nr.03/-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ka përcaktuar që: *"Zyrtarët e lartë drejtues dhe zyrtarët drejtues në shërbimin civil, mund të caktohen në pozita të ndryshme me gradë ekuivalente për një periudhë të caktuar kohore, por jo më shumë se gjashtë (6) muaj"*, mirëpo me miratimin e zyrtarit dhe propozimin e institucionit, ai mund të caktohet për një periudhë të pacaktuar kohore në një pozitë siç parashihet me paragrafin 2 të këtij neni, si rrjedhojë meqë ka pasur pëlqim të ankuesit dhe institucionit është bërë edhe transferimi i ankuesit, duke bazuar edhe në nenin 10 të Rregullores Nr. 06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civilë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, që transferohen në lokacion tjetër, më larg se pesë (5) km nga vendi aktual i punës së tij, i kompensohen shpenzimet e udhëtimit, siç parashihet me nenin 5 paragrafi 5 të Rregullores Nr. 06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, po ashtu edhe dispozitat e Rregullores (QRK) NR.14/2020 Për Transferimin E Nëpunësve Civilë, gjegjësisht neni 9 paragrafi 2, përcakton se: *"Nëpunësit civil, i cili transferohet në një vend tjetër pune me kërkesën e institucionit, në një lokacion tjetër, i cili është më i largët se sa vendi i tij i rregullt i punës, i kompensohen shpenzimet e udhëtimit nga institucioni, i cili e transferon nëpunësin"*, bazuar në këtë kompensimi i shpenzimeve sipas këtyre dispozitave aplikohet vetëm në rastet kur kemi të bëjmë me transferim të përkohshëm, ndërsa tek rastet e transferimit të përhershëm, këto rregullore nuk kanë paraparë që nëpunësve t'i bëhet kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit, në këtë rast pretendimet e ankuesit që t'i bëhet kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit për vajtje-ardhje në vlerën 1 Euro sipas nenit 5 të Rregullores Nr. 06/2010 për Transferimin e nëpunësve Civil, janë të pabazuara.



Lidhur me Vendimin me Nr.01062 i datës 20.09.2021 i Zv. Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës për shfuqizimin e Vendimit me Nr. 4391 të datës 24.12.2019, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, nuk është lëshuar në trajtimin e mëtejshëm për faktin që në bazë të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative konkretisht neni 53 paragrafi 1, përcakton se: *“Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj”*.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit si dhe në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda,A.nr.1227/2021, datë 10.02.2022

Avdyl BEKTESHI,

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.